



**PROCESVERBAL I ASAMBLESË SË JASHTËZAKONSHME TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR AGRIGOSE SH.P.K.**

Sot më 12 Maj 2005, në orën 17.00, para meje Mimoza Sadushi, Notere ne Tiranë, e regjistruar në Dhomën e Noterisë Tiranë,

u paraqitën

1. shoqëria e së drejtës italiane Valeria Italia S.r.l. (më poshtë "Valeria Italia"), zotëruese e një pjese të kapitalit e barabartë me 68.73% të kapitalit të shoqërisë Agrigose Sh.p.k. (më poshtë "Shoqëria"), e përfaqësuar nga Z. Michele Cicella, qytetar italian, lindur në San Paolo di Civitate (FG), Itali, më 07.01.1944, me nr. pashaporte 655792T, i cili merr pjesë në këtë asamble në cilësinë e administratorit të vetëm dhe të përfaqësuesit ligjor të Valeria Italia;
2. Ministria e Ekonomisë (më poshtë "Ortaku Shtetërorë"), zotëruese e një pjese të kapitalit e barabartë me 17.27% të kapitalit të Shoqërisë, e përfaqësuar nga Z. Llazar Sema, qytetar shqiptar, lindur në Lushnje, Shqipëri, më 15.10.1944, me nr. letërnjoftimi QH 437114, i cili merr pjesë në këtë asamble në cilësinë e të autorizuarit nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, që i bashkëngjitet këtij dokumenti si Shtojca 1;
3. shoqëria e së drejtës italiane SIMEST S.p.A. (më poshtë "SIMEST"), zotëruese e një pjese të kapitalit e barabartë me 14% të kapitalit të Shoqërisë, e përfaqësuar nga Av. Erinda Ballanca, qytetare shqiptare, lindur në Tiranë (Shqipëri), më 29 Tetor 1973, me nr. licence 618, e cila merr pjesë në këtë asamble në bazë të vendimit të Këshillit Administrativ të SIMEST, më 24 Nëntor 2004, i cili i bashkëngjitet këtij dokumenti si Shtojca 2;

Merr drejtimin e Asamblesë Z. Michele Cicella, i cili deklaron se Asamblea e Jashtëzakonshme është mbledhur ligjërisht për të diskutuar dhe vendosur si vijon

rendi i ditës

1. transferimin e pjesëve të kapitalit të shoqërisë në pronësi të SIMEST tek Valeria Italia;
2. Ndryshimet e nevojshme në statutin e Shoqërisë;
3. Të ndryshme.

pasi konstatohet

prania e ortakëve që përfaqësojnë të gjithë kapitalin e Shoqërisë, Kryetari

deklaron

se Asambleja është mbledhur rregullisht dhe ka të drejtë të vendosë mbi rendin e ditës.

* * *

1. **Trasferimi i pjesëve të kapitalit të shoqërisë në pronësi të SIMEST tek Valeria Italia.**

Sipas pikës nr. 1) të rendit të ditës, Kryetari komunikon se ortaku SIMEST dhe ortaku Valeria Italia kanë nënshkruar, më datë 14 Mars 2002, një kontratë për shitjen e 14% të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë në pronësi të SIMEST tek Valeria Italia, për cmimin e caktuar ndërmjet Palëve në shumën 480.000.000 (quattrocento milioni) Lireta Italiane. Kjo kontratë nuk është hartuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, dhe për këtë arsye, shitja e pjesëve të kapitalit nuk është regjistruar akoma në Regjistrin e Shoqërive, siç parashikohet në legjislacionin shqiptar.

Duke qenë se është e nevojshme të kryhet procedura e rregullt sipas ligjit shqiptar për shitjen e pjesëve të kapitalit të zotëruara nga SIMEST në kapitalin e Shoqërisë, Kryetari fton asamblenë të vendosë mbi këtë pikë.

Në mbështetje të nenit 47 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të nenit 9 të Statutit të Shoqërisë, duke qenë se për shitjen e pjesëve të kapitalit të shoqërisë tek të tretët kërkohet pëlqimi i ortakëve që përfaqësojnë të paktën 3/4 e kapitalit të shoqërisë, Kryetari i propozon Asamblesë miratimin e shitjes së pjesëve të kapitalit të zotëruara nga SIMEST tek Valeria Italia.

Pasi u dëgjua relacioni i Kryetarit dhe u mbyll diskutimi mbi pikën nr. 1) të rendit të ditës, Asambleja, me unanimitet

vendosi

- të miratojë shitjen e pjesëve të kapitalit, të barabarta me 14% të kapitalit të Shoqërisë, nga shoqëria SIMEST tek shoqëria Valeria Italia.

Në përfundim, për efekt të këtyre vendimeve, struktura e ortakërisë së shoqërisë është si vijon:

Ortaku	Pjesëmarrja
Valeria Italia S.r.l.	82.73%
Ortaku Shtetëror	17.27%
Totali	100%

2. **Ndryshimet e nevojshme në Statutin e Shoqërisë**

Duke kaluar në diskutimin e pikës nr.2) të rendit të ditës, Kryetari deklaroi se, për pasojë të vendimit në pikën nr.1) më lart, duhet të ndryshohet neni 10 i Statutit të Shoqërisë, me ndryshimet e bëra në datë 22 Dhjetor 1993. Kryetari lexon tekstin e Statutit, pas ndryshimeve. Asambleja, pasi degjon propozimin e Kryetarit, dhe diskuton mbi këtë pikë, me unanimitet


vendos


- të miratohet tekstin e ri të Statutit të shoqërisë, sic u lexua nga Kryetari e që ndryshohet si vijon:


"Neni 10 - Kapitali i shoqërisë, i barabartë me 185.643.000 (njëqindetëdhjetëepesëegjashtëqindëedyzetëetremijë) lekë, sipas kontributeve të ortakëve i ndarë në pjesë sipas ligjit, i cili mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve".


Duke qënë se nuk mbetet asnjë pikë tjetër për t'u diskutuar dhe askush nuk e kërkoi fjalën, Kryetari deklaroi të shpërndarë Asamblesë në orën 17.30. Procesverbali u hartua në 4 kopje origjinale, në gjuhën italiane dhe shqipe. Unë Noteri e lexova për palët, të cilët e miratuan dhe më deklaruan se gjejnë plotësisht në përputhje me vullnetin e tyre.


Nënshkrimet:


Për Valeria Italia S.r.l.
Z. Michele Cicella



Për Ortakun Shtetëror
Sig. Ljazar Sema


Erindo Ballanca
Për SIMEST
Av. Erinda Ballanca




Përkthyesë
Gentiana Koduzi




Noter
Mimozha Sallushi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 3338 Rep.
Nr. 1047 Kol.



KONTRATË PËR SHITJEN E PJESËVE TË KAPITALIT

Sot më datë 12.05.2005, në Tiranë, përpara meje, Noteres Mimoza Sadushi, u paraqitën palët e mëposhtme për identitetin e të cilëve unë Noterja jam e sigurt:

- Shoqëria e të drejtës italiane **SIMEST S.p.A.**, me seli në Romë, Corso Vittorio Emanuele II n. 323 (me Kod Fiskal 04102891001), përfaqësuar nga avokat Erinda Ballanca, qytetare shqiptare, lindur në Tiranë, (Shqipëri), më 29 tetor 1973, n. licënce profesionale 618, e cila përfaqëson Shoqërinë në bazë të vendimit të Këshillit Administrativ të SIMEST S.p.A., më 24 nëntor 2004, që i bashkëngjitet këtij akti në Lidhjen n. 1 (këtej e tutje "SIMEST" ose "Shitës")

Nga njëra anë

dhe

- Shoqëria e të drejtës italiane **Valeria Italia S.r.l.** me seli në Foggia (FG), via Trento 2/C (me Kod Fiskal 01867360719) përfaqësuar nga Z. Michele Cicella, qytetar italian, lindur në San Paolo Civitate (FG), Itali, më 07.01.1944, n. pasaporte 655792T, në cilësinë e administratorit të vetëm dhe përfaqësuesit ligjor të Valeria Italia S.r.l. (këtej e tutje "Valeria Italia" ose "Blerësi");

Nga ana tjetër

të dyja palët me aftësi të plotë për të vepruar, me vullnet të lirë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, pranojnë të lidhin dhe në fakt lidhin këtë Kontratë për Shitjen e pjesëve të kapitalit sipas kushteve të mëposhtme.

Kushte paraprake

- Shoqëria SIMEST është zotëruese e një pjese të kapitalit, të barabartë me 14% (katërmëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë të së drejtës shqiptare, "Agrigose" Sh.p.k., me seli në Gose - Kavajë (Shqipëri), regjistruar pranë Regjistrat Tregtar të Tiranës, më 25.10.1993, me vendimin numër 7552 (këtej e tutje Shoqëria);
- Shoqëria Valeria Italia është zotëruese e një pjese të kapitalit të barabartë, me 68,73% (gjashhtëdhjetë e tetë /73) të kapitalit të Shoqërisë;
- Shitësi dhe Blerësi kanë nënshkruar në datë 14.03.2002 një kontratë për shitjen e 14% (katërmëdhjetë përqind) të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë, në pronësi të SIMEST, në favor të Valeria Italia, me një çmim prej 480.000.000 liretash italiane (katërqind e tetëdhjetë milion), shumë e cila është paguar tërësisht jashtë zyrës së noterisë. Kjo kontratë nuk ishte hartuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, dhe për këtë arsye shitja e pjesëve të kapitalit nuk është regjistruar akoma në Regjistrin Tregtar, si parashikon ligji shqiptar, duke mos prodhuar asnjë efekt mbi Shoqërinë dhe të tretët;
- Shitja e pjesëve të kapitalit është e autorizuar rregullisht nga asamblea e ortakëve të Shoqërisë më datë 12.05.2005;
- Duke qënë se është i nevojshëm perfeksionimi i shitjes në favor të Valeria Italia të pjesëve të kapitalit të zotëruara nga SIMEST në Shoqëri, Blerësi dhe Shitësi dëshirojnë të nënshkruajnë kontratë për shitjen e pjesëve të kapitalit në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi me anë të së cilës Blerësi blen dhe Shitësi shet 14% (katërmëdhjetë përqind) të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë, sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme;

EB *M. Sadushi*

Meqë ekzistojnë kushtet paraprake, palët me zotësi të plotë për të vepruar dhe me vullnetin e tyre të lirë pranojnë të nënshkruajnë dhe në fakt nënshkruajnë këtë Kontratë për Shitjen e pjesëve të kapitalit (këtej e tutje "Kontrata"), sipas kushteve të mëposhtëme:

Neni 1
Kushtet paraprake të sipërpërmendura janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.

Neni 2

- 2.1. Shitësi merr përsipër t'i shesë dhe transferojë Blerësit, dhe Blerësi merr përsipër të blejë, 14% (katërmbëdhjetë përqind) të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë të zotëruara nga Shitësi, tërësisht të lira nga çfarëdolloj detyrimi në favor të të tretëve, me një çmim të barabarë me 480.000.000 lireta italiane (katërqind e tetëdhjetë milion) këtej e tutje çmimi, të barabarë me 247.899,31 Euro (dyqind dyzet e shtatë mijë e tetëqind nëntëdhjetë e nëntë /31.
- 2.2. Pagimi i çmimit, sipas nenit 2.1, është bërë më datë 14.03.2002 jashtë zyrës së noterit dhe kjo Kontratë përbën dëshmi pagese me efekte liruese.

Neni 3

- 3.1 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Shitësit.
- 3.2 Blerësi merr përsipër të lirojë dhe garantojë Shitësin, pas kërkesës së këtij të fundit, dhe menjëherë, nga çdo detyrim, shpenzim, barrë dhe humbje që i ngarkohet Shitësit për shkak të mos lidhjes së kontratës në formën e kërkuar nga ligji shqiptar, duke filluar nga data 14.03.2002.
- 3.3 Shitësi pranon shprehimisht se nuk ka asnjë pretendim ndaj Blerësit dhe/ose nga Shoqëria duke filluar nga data 14.03.2002, në lidhje me (i) çfarëdo lloji të drejte mbi pronësin, përfshirë edhe të drejtën për të përfituar të ardhura që mund të jenë ndarë nga Shoqëria; (ii) çfarëdo lloji të drejte të natyrës administrative, përfshirë edhe të drejtën për të marrë pjesë në asamblen e ortakëve dhe për të votuar.

Neni 4

Kjo kontratë është e detyrueshme për palët dhe do të jetë e vlefshme si midis tyre, ashtu edhe për trashëgimtarët e tyre.

Neni 5

Kjo kontratë përfshin tërësisht marrëdhëniet midis palëve dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme që janë të lidhura me këtë objekt. Kjo Kontratë mund të ndryshet vetëm me shkrim dhe teksti i ndryshuar duhet të nënshkruet nga të gjitha palët dhe t'i bashkëngjitet asaj.

Neni 6

Kjo kontratë dhe të drejtat e detyrimet e palëve do të disisplinohen e ushtrohen në bazë të së drejtës shqiptare.

Neni 7

- 7.1 Të gjitha mosmarrëveshjet midis palëve që mund të lindin ose që lidhen me interpretimin dhe/ose zbatimin e kësaj kontrate, që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim midis palëve, duhet të vendosen eskuzivisht dhe në mënyrë përfundimtare nga një kolegji arbitral me seli në Tiranë.
- 7.2 Arbitrazhi do të përbëhet prej 3 arbitrash, dy prej të cilëve emërohen respektivisht prej palëve, dhe i treti me funksionin e Kryetarit, i zgjedhur me një marrëveshje të thjeshtë nga dy të parët. Në rast se nuk arrihet marrëveshja, brenda 20 (njëzet) ditëve nga emërimi i arbitrit të dytë Kryetari i Gjykatës së Tiranës me kërkesën e palës më të interesuar, do të emërojë Kryetarin e arbitrazhit. Në rast se njëra nga palët nuk ka emëruar arbitrin e vet brenda 20 (njëzet) ditëve nga marrja e ftesës së palës tjetër, Kryetari i Gjykatës së Tiranës do të jetë kompetent edhe për të emëruar arbitrin e palës më pak të interesuar.
- 7.3 Arbitrazhi do të zbatojë ligjin shqiptar. Gjuha e arbitrimit do të jetë gjuha italiane.

- 7.4 Arbitrazhi do të marrë vendimin e vet brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga data në të cilin arbitri i fundit ka pranuar emërimin. Afati mund të zgjatet për jo më shumë se një herë, mbi bazën e një marrëveshjeje të shkruar midis anëtarëve të arbitrazhit ose me vendim të vetë arbitrazhit, për një periudhë jo më gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë.
- 7.5 Arbitrazhi do të vendosë sipas ligjit dhe vendimi i tij, që do të ketë efekte detyruese kundrejt palëve si shprehje e vet vullnetit të tyre, nuk do të jetë objekt i ndonjë apelimi ose kundërshtimi.


Neni 8

Kjo Kontratë është nënshkruar në 4 (katër) origjinale, në gjuhën italiane me shtojcë përkthimi në gjuhën shqipe, të nënshkruara nga palët në datë 12.05.2005. Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin e kësaj Kontrate versioni italisht do të jetë i vetmi dhe do të jetë ligjërishit detyrues.


Kjo kontratë nënshkruhet nga të dyja palët në Tiranë, më datë 12.05.2005.

Unë Noterja ia lexova palëve këtë Kontratë, të cilat më deklaruan se e gjejnë në përputhje të plotë me vullnetin e tyre. Kjo Kontratë përmban 3 (tre) faqe dhe 8 (tetë) nene, nënshkruhet nga palët në praninë time dhe unë Noterja vërtetoj vullnetin e tyre sipas ligjit.


Shitësi


Erinda Ballanca
SIMEST S.p.a.
e përfaqësuar nga
Av. Erinda Ballanca


Blerësi


Z. Michele Cicella
Valeria Italia S.r.l.
e përfaqësuar nga
Z. Michele Cicella

Përkthyes


Gentiana Koduzi

Noter


Mimoza Sadushi

**VERBAL I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“AGRIGOSE”
GOSE – KAVAJE**

Me date **23 qershor 2014**, ne ora 19:00, prane selise se **Deloitte Albania Sh.p.k.**, ne adresen: Rr. Elbasanit, Pall. Poshte Fakultetit Gjeologji Miniera – Tirane 1000, u mbledh Asambleja e Pergjithshme e Shoqerise, me kete:

REND DITE:

1. Komunikim i transferimit te kuotave qe ka ne “AGRIGOSE” Sh.p.k., Shoqeria “VALERIA ITALIA” S.r.l. tek Shoqeria “MERKATOR – A” Sh.p.k.
2. Prezantim i raportit te ndermjetem te administrimit te Shoqerise deri me date 31 maj 2014
3. Doreheqja e Administratorit te vetem te Shoqerise, Z. Michele Cicella
4. Lirimi nga pergjegjesite e Administratorit te vetem qe dorehiqet.
5. Emerim ne detyren e Administratorit te Vetem, me nje mandat 5-vjecar nga data e emerimit, te Z. Maksim CASLLI, i biri i Hakiut, lindur ne Tirane, me 03.07.1967, mbajtes i pasaportes se Shteteve te Bashkuara te Amerikes nr. 490090890.

Merr Presidencen, ne baze te Statutit social ne fuqi, Dott. Michele Mario Cicella, Administratori i vetem i Shoqerise, i cili

KONSTATON

Qe kjo Asamble eshte thirrur rregullisht;

Qe kapitali social prej 185.643.000 Leke i perket ortakeve te cilesuar me poshte per kuotat e saktesuara te secilit prej tyre:

1. Shoqeria “MERKATOR – A” Sh.p.k. (ne vazhdim “MERKATOR – A”), titullare e nje kuote te barabarte prej 82,73% (tetedhete e dy, shtatedhete e tre per qind) te kapitalit social te “AGRIGOSE” Sh.p.k. (ne vazhdim “Shoqeria”), e perfaqesuar ne kete Asamble nga Administratori i vetem dhe perfaqesuesi legal, Z. Maksim Caslli, qytetar amerikan, lindur me 3.07.1967 ne Tirane, me Nr. Pasaporte 4900900890
2. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregetise dhe Siper marrjes (ne vazhdim “ortaku shteteror”), titullar i nje kuote te barabarte prej 17,27% (shtatembedhete, njezet e shtate per qind), e perfaqesuar nga Z. Alban BEQAJ, i biri i Myrdashit, lindur ne Shkoder, me 26.04.1969, banues ne Tirane, rruga “Frang Bardhi”, Njesia Bashkiake nr.5, Kulla 2, Qendra Kristal, mbajtes i leternjoftimit me numer personal G90426047L. Autorizimi i bashkengjitet vendimit me cilesine e pjeses integrale.);

Qe jane prezente ortaket qe perfaqesojne totalin e kapitalit;

Qe eshte prezent Administratori i vetem personalisht;

Qe Asamblea, nga sa u tha me lart, mund te jete vlefshmerisht e mbledhur;

Bilbili  

Qe eshte prezent Znj. Tefta Bilbili, Sekretare e "Shoqerise";

DEKLARON

Se Asambleja eshte thirrur rregullisht dhe mund te diskutoje dhe vendose mbi rendin e dites se pershkruar me lart.

Duke mbajtur parasysh sa u tha me lart, fton te kryeje rolin e Sekretares dhe te perkthyeses, Znj. Tefta Bilbili, e cila pranon dhe falenderon.

Presidenti komunikon qe me Kontraten e Shitjes se Kuotave te dates 23.06.2014 te notere Gentiana Shkodra, "Valeria Italia" ka transferuar te tere pjesemarrjen e saj ne "Shoqeri", te barabarte me 82,73% te kapitalit ne favor te blesesit "MERKATOR - A" Shpk.

Presidenti, ne vijim te transferimit te pjesemarrjes, e konsideroi te nevojshme te therrase Ortaket ne Asamble per sqarimet ne vazhdim: t'i prezantoje Ortakeve raportin e ndermjetem te administrimit deri me 31 maj 2014 dhe te doreheqjes se tij nga detyra si Administrator i vetem i Shoqerise.

Presidenti lexon Dokumentin e hartuar nga Konsulentja kontabel dhe fiskale e Shoqerise deri me 31 maj 2014 dhe konfirmon:

"Dokumenti eshte perpiluar ne baze te Ligjit Nr. 9228 te dates 29.04.2004 "Mbi Kontabilitetin" dhe perfaqeson me vertetesi dhe korrektese situaten pasurore te "Shoqerise", si dhe rezultatin ekonomik te drejtimit social deri me 31 maj 2014 me te dhena te dala nga regjistrimet e rregullta kontabile ne menyre qe Ortaket te mund te kene informacione te sakta per vleresim.

Shoqeria ne periudhen 1 janar 2014 deri me sot ka realizuar te ardhura per 588.000 Leke.

Shpenzimet perbehen nga pagat e personelit, nga kontributet dhe taksat ne favor te Financave te Shtetit, te paguara me perpikmeri; dhe nga shpenzimet administrative, qe rezultojne mjaft te permbajtura. Asnje kompensim nuk i eshte dhene si edhe ne vitet e meparshme Administratorit te vetem te "Shoqerise".

Kreditet jane paraqitur me vleren e tyre nominale qe i korrespondon asaj te supozuar; ato ndaj Administrates financiare perfaqesohen nga krediti i T.V.SH., sic rezulton nga deklarimi i fundit mujor, dhe nga krediti i Tatim Fitimit, rregullisht te paguar, por jo i duhur. Debitet jane paraqitur me vleren e tyre nominale.

Persa i perket detyrimeve per pagesen e kontributeve, pagat personelit apo ndaj furnitoret, informojme qe "Shoqeria" nuk ka, ne ditin e sotme, detyrime te prapambetura ndaj personelit o ndaj furnitoreve; dhe qe eshte ne zhvillim nje padi ndaj Drejtorise Rajonale te Taksave - Durres mbi pretendimin e pa baze per shuma te detyrimeve te supozuara te prapambetura te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore. Ne fund jane regjistruar ne kete Dokument detyrimet e skaduara te "Shoqerise" ndaj INTESA SAN PAOLO Bank dhe Societe' Generale AL, me mbetje llogarie qe kane dale nga Certifikata e leshuar Shoqerise nga Banka e Shqiperise me date 7 maj 2014, qe

Bilbili



bleresi i ka marre persiper, sipas kontratave te perpiluara me date 2 qershor 2014 midis Shoqerise "AGRIGOSE" Sh.p.k. dhe Shoqerise "MERKATOR - A" Sh.p.k..

Persa i perket shumes prej 48.923.040 Leke, e mendojme te nevojshme te saktesojme edhe nje here qe, si detyra dhe nga Ortaket, qe ky debit nuk paraqet hua afatgjata te marra nga "Shoqeria", por i perket kreditit financiar te "ortakut shteteror" i dale nga rivleresimi i pasurive te paluajtshme ne pronesi te "Shoqerise", kredit qe u dha ne kapitalin themelor te joint-venture si kontribut ne natyre nga N.B.GOSE; duke e specifikuar perseri qe rivleresimi i pasurive u krye ne vitin 2001 me kerkese te Ministrise se Bujqesise dhe qe vlera prej 48.923.000 Leke perfaqeson vleren e kuotes qe "ortaku Shteteror" do te nenshkruaje ne momentin e kryerjes se rritjes se kapitalit social, sapo te percaktohet ne favor te "Shoqerise" mosmarreveshja ne vijim me Shtetin dhe Zyra e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme do te marre masa per kompletimin e regjistrimit te te gjitha pasurive ne emer te saj".

Administratori i vetem i Shoqerise deklaroi te mbyllur mandatin e tij, paraqet doreheqjen nga detyra dhe u kerkon Ortakeve ta lehtesojne, sipas praktikes, nga cdo pergjegjesi per gabime te mundshme te kryera prej tij ne besim ne kryerjen e funksionit te tij e ne limitet e fuqive te tij.

Fton, per kete Ortaket, te emerojne Administratorin e vetem te Shoqerise.

Kerkon fjalen Z. Maksim Caslli, i cili propozon kandidaturen e tij per kete detyre.

Asambleja, pas diskutimeve te shkurtra, me miratimin e ortakut posedues te 82,73 % te kapitalit, duke qene i legjitimuar qofte si shumice e thjeshte ashtu dhe e kualifikuar,

VENDOS

1. Te aprovoje raportin e ndermjetem te administrimit deri me 31 maj 2014
2. Te pranoje doreheqjen e paraqitur nga Administratori i vetem, Dott. Michele Mario Cicella, dhe e falenderon per punen e kryer prej tij
3. Te lehtesoje Dott. Michele Mario Cicella nga cdo pergjegjesi per gabime te mundshme ne kryerjen e detyres se tij dhe ne limitet e fuqise se tij. Vendos, gjithashtu, qe "Shoqeria" te marre persiper, edhe ne perballje me administraten publike o te enteve qe drejtojne kontributet, debitet per sanksione si rrjedhim te shkeljeve qe Administratori i vetem i "Shoqerise" mbase mund te kete kryer.
4. Te emeroje Administrator te vetem te Shoqerise Z. Maksim Caslli, per nje mandat 5-vjecar nga i cili pranon dhe falenderon.

Administratori i vetem i emeruar do te marre masa per plotesimin ne vijimesi brenda afateve ligjore te detyrimeve, midis te cilave edhe depozitimi i ketij Verbali prane Q.K.R., sipas ligjit.

QENDRIMI I ORTAKUT MZHETS (emertimi i meparshem METE)

Perfaqesuesi i MZHTS, Z. Alban BEQAJ, ne perputhje me autorizimin e dhene u shpreh:

1. Lidhur me piken 1 te rendit te dites:"Bazuar ne Nenin 36 KPC, kundershtojme cdo transakcion ne lidhje me shitjen e kuotave qe zoteron Ortaku "Valeria Italia" Srl ne

Bilibi, 

"Agrigose" Shpk Kavaje, tek te trete, deri ne nje vendim marrje perfundimtare nga organet gjyqesore kompetente per procesin gjyqesor ne vijim, ne te cilin Shoqeria "Agrigose" Shpk Kavaje si dhe individe te tjere qe jane pale e paditur, me kerkese padi te perfaqesuar nga Avokatura e Pergjithshme e Shtetit Shqiptar. Me shkresen tone nr. 23463 date 24.04.2014 drejtuar perfaqesueses se Ortakut "Valeria Italia" Srl ne "Agrigose" Shpk, Kavaje si dhe Administratorit te Shoqerise kemi sqaruar sa me siper.

2. Lidhur me pikën 2 te rendit te dites se mbledhjes, shprehemi se nuk disponojme material mbi prezantimin e situates pasurore dhe ekonomike te Shoqerise ne daten 31.05.2014. Rezervojme te drejten te shprehemi per kete ceshtje ne mbledhjen e ardhshme te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise, mbasi te disponojme kopje te ketij materiali.
3. Nuk miratojme doreheqjen e Administratorit te Vetem te Shoqerise, per arsyen e parashtruar ne pikën 1 te qendrimit tone sa me siper.
4. Nuk miratojme sa propozohet ne pikat 4 dhe 5 te rendit te dites se mbledhjes."

Duke mos pasur vendime te tjera per te marre e pasi asnje nuk kerkoi fjalen, Presidenti deklaroi te mbyllur Asamblene, pas redaktimit te ketij verbali qe, lexohet, aprovohet dhe nenshkruhet nga Presidenti dhe Sekretari ne ora

SEKRETARI

Tefta Bilbili

Tefta Bilbili

Bilbili

PRESIDENTI

Michela Mario Cicella

Michela Mario Cicella

ORTAKET E PRANISHEM

MERCATOR - A

MZHETS

Maksim Casli

MAKSIM CASLLI

Alban Beqaj

Perf. ALBAN BEQAJ

Administratori i vetem i liruar nga detyra

Michela Mario Cicella

MICHELE MARIO CICELLA

Administratori i vetem i emeruar, ne pranim te detyres

Maksim Casli

MAKSIM CASLLI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Dhome e Noterise Tirane
NR 5406 REP
NR 506 COL

REPUBBLICA ALBANESE
Collegio dei Notai di Tirana
NR 5406 REP
NR 506 KOL



KONTRATË SHIT – BLERJEJE KUOTE

CONTRATTO DI CESSIONE DI QUOTA

Sot më datë 23.06.2014, në Tiranë, janë paraqitur para meje Gentiana Shkodra, Notere e regjistruar pranë Dhomës së Noterëve të Tiranës, palët e mëposhtme të cilat bien dakord për sa vijon:

Oggi in data 23.06.2014, in Tirana, davanti a me Gentiana Shkodra, Notaio iscritto all'Ordine Notarile di Tirana, le seguenti parti convengono quanto segue:

Shoqëria **Mercator – A sh.p.k.**, me seli në RR."Dëshmorët e 4 Shkurtit", Ndërtesa 40, Hyrja 8, Ap. 55, Tirana, Albania, numër regjistrimi dhe numri i regjistrimit në taksa K91616024E, përfaqësuar nga Administratori, Z. Maksim Caslli, shtetas amerikan me numër pasaporte: 490090890 ("**Blerësi** ")

La Società **Mercator – A sh.p.k.**, con sede legale a RR."Dëshmorët e 4 Shkurtit", Ndërtesa 40, Hyrja 8, Ap. 55, Tirana, Albania, numero di registrazione e numero fiscale K91616024E, rappresentata dall'Amministratore Sig. Maksim Caslli, cittadino americano, con numero di passaporto: 490090890 (il "**Cessionario**")

Dhe

E

Shoqëri **Valeria Italia s.r.l.**, me seli në Via Trento, n. 2/c. 71121, Foggia, Italia, me numër fiskal 01867360719 përfaqësuar nga administratori i saj i vetëm Z. Michele Cicella, shtetas italian, me numër pasaporte: AA4584934 ("**Shitësi**")

La Società **Valeria Italia s.r.l.**, con sede legale in, Via Trento, n. 2/c. 71121, Foggia, Italia, con numero fiscale 01867360719 rappresentata dall'Amministratore Unico Sig. Michele Cicella, cittadino italiano con numero di Passaporto: AA4584934 (il "**Cendente**")

(Shitësi dhe Blerësi referohen bashkarisht si "**Palët**" ose individualisht si "**Pala**")

(il Venditore ed il Compratore congiuntamente qui di seguito "**le Parti**" e singolarmente "**la Parte**")

Hyrje

MEQËNËSE:

- A. Agrigose, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e thelemuar rregullisht dhe që funksionon sipas legjislacioni shqiptar, me seli në Kavajë, Komuna Gosë, Shqipëri, e regjistruar me numër NUIS J72902823F (ne vijim referuar si "**Shoqëria**");
- B. Shitësi zotëron një kuotë 82.73 % ("**Kuota**"), të kapitalit të shoqërisë Agrigose sh.p.k.;
- C. Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit dhe Blerësi dëshiron të përfitojë pronësinë mbi kuotën, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.
- D. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, zotëruese e kuotës prej 17,27% te kapitalit shoqëror të "Agrigose", nuk e ka ushtruar të drejtë e parablerjes mbi kuotën e sipërpërmendur brenda afatit kohor të parashikuar në statutin e shoqërisë për çmimin e përcaktuar me letër të dërguar nga Shoqëria "Valeria Italia" S.r.l. në datë 28 mars 2014 nëpërmjet shërbimit postar rekomandë me njoftim pranimi; dhe për pasoje nuk ka pengesa për shitjen e kuotës.
- E. Palët kanë tagrat e plota të kërkuara për të lidhur këtë Kontratë dhe për të përmbushur detyrimet sipas saj.

PRANDAJ, Palët lidhin këtë Kontratë Shit-Blerjeje Kuote ("**Kontrata**"), si në vijim:

1. Shitja dhe Blerja e Kuotës

Preambolo


PREMESSO CHE:

- A. Agrigose, è una società a responsabilità limitata, regolarmente costituita e funzionante in rispetto della legislazione albanese, con sede legale a Kavajë, Comune di Gose, Albania iscritta con Codice Fiscale no. J72902823F (qui di seguito "**la Società**");
- B. Il venditore possiede una quota di 82, 73 % ("**la Quota**"), nel capitale sociale della Società Agrigose sh.p.k.;
- C. Il Venditore desidera vendere al Compratore ed il Compratore desidera ricevere la titolarità della quota, in conformità con le condizioni e i termini specificati in questo Accordo.
- D. Il Ministero dello Sviluppo Economico, Commercio e Imprenditoria, titolare di una quota pari al 17,27% del capitale sociale dell'"AGRIGOSE", non ha esercitato il diritto di prelazione sulla quota di cui sopra entro il termine previsto nello Statuto della società per il prezzo indicato con lettera inviata dalla Società "VALERIA ITALIA" S.r.l. in data 28 marzo 2014 a mezzo del servizio postale con raccomandata con avviso di ricevimento; e pertanto non sussistono ostacoli alla vendita.
- E. Le Parti possiedono le competenze necessarie per stipulare questo Contratto e per poter soddisfare gli obblighi previsti in esso.

PER CUI, le Parti stipulano questo Contratto di Compravendita di Quota ("**il Contratto**") come segue:

1. Compravendita della Quota





Me anë të këtij dokumenti Shitësi **i shet** Kuotën e tij Blerësit dhe Blerësi nëpërmjet këtij dokumenti **i blen** Shitësit Kuotën sipas kushteve dhe afateve të kësaj Marrëveshje.

2. Çmimi i Shitjes

- 2.1 Blerësi do t'i paguajë Shitësin për blerjen e Kuotës çmimin total të blerjes të barabartë me 575,000.00 EUR (pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë Euro) ("**Çmimi**") i cili do të paguhet si më poshtë:
- 2.1.1 Blerësi i ka paguar Shitësit shumën prej 50,000 EUR (pesëdhjetë mijë Euro) nga cmimi i Blerjes në formën e paradhënies së pagesës së Çmimit më datë 19.05.2014 në përputhje me nenin 2.1.1 të Kontratës Paraprake të firmosur nga Palët në datë 14.05.2014.
- 2.1.2 Vlera prej 225.000,00 EUR (dyqind e njëzet e pesë mijë Euro) do të paguhet nga Blerësi brenda datës 31 gusht 2014.
- 2.1.3 Vlera e mbetur prej 300.000,00 Euro (treqind mijë Euro) do të paguhet nga Blerësi në dy këste me vlera të barabarta (150.000,00 euro secila) të cilët do paguhet i pari brenda datës 31 Tetor 2015 dhe i dyti brenda datës 31 tetor 2016.
